



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 19 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21/07/2022

**VENDIM**

Nr.19, date 21 /07/2022

**PËR**

**PROJEKTIN E ZBATIMIT PER REHABILITIMIN E DIGES SE PACOMIT, PERMET**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Digave të M. Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.07.2022 mori në shqyrtim Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Bashkia Permet, si shfrytëzuese e kesaj dige, në lidhje me Reabilitimin e diges se Pacomit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ardhur rezultonte se gjendja aktuale e elementeve kryesore të diges dhe rezervuarit të krijuar prej saj është problematika dhe është e nevojshme reabilitimi i disa pjesëve të saj si trupi i diges, ujeleshuesi, sistemi i shkarkimit, etj. Rezervuari i kesaj dige rezulton të jetë i mbushur në një masë me shumë se 30 % me sedimente. Njekohesisht rezulton që nuk ka asnjë matje të volumeve aktuale të ujit në rezervuar dhe mungon Plani I gadishmerisë në rastet e emergjencave civile për shkak të prishjes së mundshme të diges apo prurjeve maksimale që mund të vijnë në rezervuar.

Pas diskutimeve të të gjithë antareve, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratoj Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Bashkia Përmet për Reabilitimin e diges se Pacomit për arsye të moskryerjes së llogaritjeve të duhura në lidhje me qëndrueshmërinë e diges si dhe të mungesës së analizës së filtrimeve të konstatuara në dige dhe përgatitjen e planit të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile duke përfshirë llogaritjen e vales verthuesë dhe hartat e permbytjeve në zonën urbane poshtë diges.

- 2- Ti kërkojë Bashkisë Përmet:

➤ Të kryej plotësimet e duhura në projektin e zbatimit për reabilitimin e digës së Pacomit sipas kërkesave të VKM Nr. 147, dt.18.03.2004 "Miratimi i rregullores për Sigurinë e digave dhe dambave". Konkretisht:

○ Të kryejë llogaritjet e qëndrueshmërisë së digës para dhe pas reabilitimit të saj

○ Të kryejë matjet batimetrike të volumeve aktuale të ujit në rezervuar dhe të përgatit kurbat e volumeve dhe të sipërfaqes së ujit në Rezervuar deri në kuotën maksimale të ujit. Të kryejë një analizë teknike në lidhje me procesin e sedimentimit në rezervuar

○ Të përgatit Planin e gadishmerisë në rastet e emergjencave civile duke përfshirë në të skenaret e alarmit, llogaritjet e vales verthuesë, hartën e permbytjeve për zonën poshtë diges duke dhënë edhe numrin e njerezve në rrezik në rast përmbytjesh,

○ Të kryejë analizën në lidhje me filtrimet në anën e poshtme të diges dhe masat për monitorimin e tyre

○ Të parashikoj furnizimin dhe instalimin e instrumentave të monitorimit për filtrimet në digë, për uljet në dige, matjen e niveleve të ujit në rezervuar, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Të dorëzojë pranë KKDM, Oponencën e kryer nga një firmë e licencuar për projektin e zbatimit në fjalë sipas kërkesave të nenit 10 dhe 27 të VKM së mesiperme.
- Të kryejë sa më shpejt të jetë e mundur prerjen dhe pastrimin e pemëve dhe shkurreve të larta në trupin e digës.
- Të përgatit dhe të dorëzojë pranë KKDM rregulloren e shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digës sipas Nenit 29 të VKM së mesiperme dhe Vendimit të KKDM Nr. 3, datë 09.10.2020 “Udhezues i përgjithshëm për hartimin e rregullores së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digave”

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

